

REPUBLIKA E KOSOVES QEVERIA E KOSOVES ZYRA E Kryeministrit SEKTORI I ARRIVES	REPUBLIKA KOSOVA VLADA KOSOVA URDHI I PRIME MINISTRI SEKTOR ARHIVE	REPUBLIC OF KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA OFFICE OF THE PRIME MINISTER ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No:	
	07.1.d	519
Nr. i faqeve Itr. stranica No. pages	Data: Datum: Date:	08 / 04 / 20 20
4		
Prishtinë/a		



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 01-01/2020
Datë: 08 / 04 / 20

Në mbështetje të nenit 8 par. 3, 4 dhe 5, të Ligjit nr.05/L-049, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, lidhur me nenin 15 par.1 dhe 72 të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), nenit 15 par.1 dhe 2, të Rregullores 06/2012, për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të datës 02.04.2012, si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.5) të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (21.02.2020), Ministria e Drejtësisë,

NJOFTON

Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar¹, z. **Rrahim Rama**, për shkak të keqadministrimit, paaftësisë profesionale dhe shkeljeve flagrante të kriterëve ligjore ose mosplotësimi të kriterëve ligjore gjatë përzgjedhjes në pozitën përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ARSYETIM

Pas një analize të detajuar nga Kabineti i Ministres së Drejtësisë kemi gjetur shkelje ligjore serioze, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, si në vijim:

Gjatë një vizite të realizuar me datë 19 mars 2020, në Fshatin Llukar, kemi vërejtur mungesë të infrastrukturës së depos që nga mbulimi e deri të asfaltimi i saj. Kësisoj, një numër i madh i veturave qëndrojnë nën qiell të hapur nën ndikimin e faktorëve të jashtëm atmosferik. Si pasojë e kësaj, pasuri të luajtshme në numër shumë të madh po humbin vlerën e tyre. Kjo nuk ka të bëjë vetëm humbje të parave që mund të fitohen me shitjen e pasurisë së konfiskuar, por gjithashtu shkakton rrezik për buxhetin e shtetit, i cili mund të detyrohet të paguaj dëmshpërblim në rast të kthimit të detyrueshëm të një pasurie të sekuestruar.

¹Sipas Ligjit nr. 05/L-049, Agjencia është organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (neni 5 par.1); Me punën e Agjencisë udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori i Përgjithshëm, neni 7 par.1); Për punën e tij dhe punën e Agjencisë, Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.

Duke mos u përkujdesur për sigurimin e një infrastrukture të përshtatshme, e cila nënkupton mosndërmarrjen e asnjë veprimi apo detyrimi ligjor për t'i ruajtur dhe mbajtur vlerën e pasurisë, Drejtori i Përgjithshëm ka vepruar në kundërshtim me Nenin 17 (3), Nenit 19 (3) LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR.

- **Dështimi në ngritjen e një data baze funksionale për pasuritë e konfiskuara dhe sekuestruara**

Për Ministrinë e Drejtësisë përbën shqetësim të madh fakti që AASK-ja që nga viti 2017², prej kur është dëmtuar databaza e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, jo vetëm që nuk i ka rikuperuar komplet të dhënat e humbura, por as nuk ka ndërmarr veprime për ngritjen e një databaze të re. Një databazë me të dhëna historike mbi çdo pasuri të konfiskuar dhe sekuestruar, nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim të procesit, në një sistem të centralizuar kompjuterik është e domosdoshme për mbajtjen e evidencës së pasurive, shton mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e të dhënave me institucionet që bashkëpunojnë me Agjencinë si dhe mundëson dhënien në kohë reale të informacioneve të kërkuara nga institucione të ndryshme në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar e korrupsionit. Kjo databazë, nuk është krijuar ndonëse është detyrim ligjor të bëhet një gjë e tillë. Kësisoj, Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i cili menaxhohet nga ai, që nga themelimi i Agjencionit, si pasojë e moskrijimit të kësaj databaze kanë manipuluar me të dhënat e shitjes dhe shfrytëzimit të pasurisë luajtshme.

Duke mos siguruar krijimin e një databaze funksionale, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, z. Rrahim Rama, ka vepruar në kundërshtim të Nenit 4 (1.5) dhe Nenit 12 të LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR dhe Nenit 3 UA MD NR. 05 /2017 PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E SHITJES SË PASURIVE TË LUAJTSHME TË SEKUESTRUARA.

- **Shitja e veturave pa një raport të vlerësimit të detajuar**

Nga rishikimi i mbi njëqind raporteve të vlerësimit teknik dhe financiar të veturave, që janë bërë nga Komisioni Vlerësues i Agjencisë, rezultoi se në shumicën dërmuese Komisioni vlerësues nuk ka marrë parasysh kilometrazhin e automjeteve motorike, dhe të njëjtat nuk prezantohen në raporte të vlerësimit edhe pse, ky është një faktor vendimtar në përcaktimin e çmimit të përafërt të veturës sipas tregut vendor ose të huaj dhe madje kjo është e paraparë në listën e përgatitur nga Agjencia. Po ashtu në disa raste gjatë vlerësimit të veturave të konfiskuara nuk është marrë parasysh data e prodhimit të veturës, kurse në raste të shumta rezultoi se nga Ankandet e shitjes së pasurive të luajtshme, dominues janë fituesit me mbiemër të njëjtë. Sikur të vlerësoheshin këto specifika të parapara me legjislacionin në fuqi, do të rrisnin vlerën e veturës në shitje dhe në këtë mënyrë do të sjellnin më shumë të ardhura në buxhetin e Kosovës. Kështu lind dyshimi i arsyeshëm që veturat e konfiskuara janë shitur nën çmimin e tregut në bazë të provave që i posedojmë si kabinet.

Duke mos u siguruar që Komisioni Vlerësues i Agjencisë të bëjë vlerësimin teknik dhe financiar të veturave në mënyrë efikase dhe transparente, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, z. Rrahim Rama, si përgjegjës kryesor ka vepruar në kundërshtim me

²PROZZO Massimiliano (EEAS-PRISTINA) [<mailto:Massimiliano.PROZZO@eeas.europa.eu>] Dërgimi i emailit nga PROZZO Massimiliano - Cooperation Section - Programme Officer – Rule of Law- European Union Office in Kosovo / EU Special Representative.

Nenin 19 (5), Nenit 3 LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR dhe Nenit 10 (2), (3) UA MD NR. 05 /2017 PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E SHITJES SË PASURIVE TË LUAJTSHME TË SEKUESTRUARA.

- **Përdorimi dhe shitja e pasurive të paluajtshme**

Sa i përket përdorimit dhe shitjes së pasurive të paluajtshme, Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi i tij nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të përcaktuar me ligjin përkatës i cili i mundëson që përmes hartimit të akteve nënligjore të përcaktohen kriteret, masat, mënyrë e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale brenda kufijve të destinimit të përcaktuara më këtë ligj, kësaj Drejtori dhe stafi i tij, kanë dështuar të propozojnë një draft të rregullores për përdorimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, që nga viti 2011 nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim lidhur me hartimin e ndonjë akti nënligjor për pasuritë e paluajtshme, edhe përkundër faktit se numri i konfiskimeve dhe sekuestrimeve të pronave të paluajtshme kanë vlerë të madhe.

Si përfundim i kësaj, provohet qartë se mosshitja dhe mosshfrytëzimi i pasurive të paluajtshme të konfiskuara dhe sekuestruara, ka krijuar dy pasoja dhe atë si në vijim:

- ka rënë dukshëm e pasurive të paluajtshme si pasojë e mosmirëmbajtjes dhe mosshfrytëzimit të tyre

- mosshitja e këtyre pasurive paluajtshme, me të hyrave në buxhetin e Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, z. Rrahim Rama, si përgjegjës kryesor ka vepruar në kundërshtim me

Nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, lidhur me Nenin 3 dhe Nenin 29 të LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR dhe Nenit 10 (2), (3) UA MD NR. 05 /2017 PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E SHITJES SË PASURIVE TË LUAJTSHME TË SEKUESTRUARA.

- **Dhënia në shfrytëzim e veturave të konfiskuara**

Nga rishikimi i listave mbi të dhënat e pasurive të sekuestruar dhe të konfiskuara që kemi siguruar nga Agjencia, kemi vërejtur raste të shumta, se Agjencia përmes vendimeve ka bërë dhënie në shfrytëzim të veturave të konfiskuara. Për fat të keq Agjencia pa ndonjë arsye nuk na ka dërguar të gjitha vendimet relevante të kërkuara përmes të cilave do të mund të bëhej vlerësimi i përputhshmërisë së vendimeve me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e Agjencisë.

Rrjedhimisht nga vendimet e analizuara dhe duke u mbështetur mbi bazën ligjore pretendojmë se Agjencia përkatëse nuk është kompetente për t'ia dhënë në shfrytëzim veturat e konfiskuara asnjë institucioni më përjashtim të Qeverisë. Nga analiza e vendimeve kemi ardhur në përfundim që disa vetura janë dhënë institucioneve tjera dhe disa të tjera i janë dhënë vetvetes.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë z. Rrahim Rama si përgjegjës kryesor ka vepruar në kundërshtim me Nenit 4 (1.3), Nenit 19 (4) LIGJI Nr. 05/L-049 - PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR, dhe Nenit 487 (3) KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE.

- **Punësimi i militantëve partiak dhe familjarëve përmes kontratave për shërbime të veçanta**

Nga informacionet që posedojmë shumica e stafit të agjencisë kanë qenë punësuar përmes lidhjeve të kontratave për shërbime të veçanta të cilat më pastaj kanë kaluar si punonjës të rregullt të Agjencisë. Kabineti i Ministres ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm që të na siguroj numrin e personave që kanë qenë në kontratë mbi vepër por deri tani pa ndonjë arsye ata kanë refuzuar ti dërgojnë emrat e personave të tillë. Kështu mospërgjigja/refuzimi i bashkëpunimit në rastin konkret nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë z. Rrahim Rama, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

- **Përzgjedhja e Rrahim Ramës si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë përkatëse**

Me 23 korrik 2011, është hapur konkurs nga MAP, për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Kriteret e përzgjedhjes për pozitën përkatëse janë si në vijim:

Përvoja e Punës:

{...} Duhet të ketë 5 vjet përvojë profesionale dhe menaxhuese, e preferueshme në nivelet e larta dhe në fusha që ndërlidhen me punën e Agjencisë.

Meqenëse, Rrahim Rama si Drejtor i Përgjithshëm aktual, ka filluar Universitetin në vitin 1982/83 dhe ka diplomuar në vitin 2010, atëherë i bie që përvoja jo adekuate është bërë para diplomimit, për faktin se personi përkatës ka fituar pozitën në 2011. Kjo përcakton qartë që Drejtori i Përgjithshëm ka përvojë pune vetëm 1 vit pas diplomimit, në kriteret e përcaktuara. Nga krejt kjo duhet ta shtojmë faktin se edhe përvoja që e ka fituar para diplomimit nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkursin e datës 23 korrik 2019.

Në mbështetje të legjislacioni në fuqi dhe argumenteve të lartpërmendura, konsiderojmë se janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore për shkarkimin nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, për shkak se i njëjti ka keqadministruar pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, ka treguar paaftësi profesionale në administrim dhe menaxhim të Agjencisë, shkelje të parimeve të ligjit për shërbyesit civil duke përfshirë edhe përzgjedhjen e tij si në pozitën përkatëse në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore.

**Albulena Haxhiu**

Ministre në detyrë e Drejtësisë